

## **NË GJYKATËN THEMELORE NË PRIZREN**

**Rasti Numër: P.169/14**

**29 Gusht 2014**

### ***NË EMËR TË POPULLIT***

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** para Kryetarit të trupit gjykues, Gjyqtarit Malcolm Simmons dhe Valentina Gashi si Procesmbajtëse, në rastin penal kundër:

**E.Y**, ..., lindur me ..... në ....., ....., ....., emri i babait ....., emri i nënës ..... (.....), qytetar i .... dhe ....., ....., jeton në ....., ....., gjendja ekonomike ‘.....’,

**AKUZUAR** në Aktakuzën e Prokurorit Special të EULEX-it PPS nr. 50/2011 me datë 07 Korrik 2014 dhe parashtruar në Zyrën e Regjistrit të Gjykatës Themelore në Prizren me datë 11 Korrik 2014 me veprën penale të Dhënia e ndihmës personit tjetër për të Kontrabanduar Migrantë, në kundërshtim me Nenet 25 paragrafi 1 dhe Neni 138 paragrafët 1, 2 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës<sup>1</sup>,

#### ***Sepse***

Në mes të datës 02 Tetor 2012 dhe 30 Nëntor 2012, E.Y, në territorin e Kosovës, e ka ndihmuar A.C ‘n, duke vepruar si anëtar i grupit duke përfshirë edhe M.Bn, T.Y, S.S dhe A.M, që ta kryejnë veprën penale të Kontrabandimit me Migrantë duke u angazhuar në kontrabandimin e personave të cilët nuk janë banorë apo banues të përhershëm të shtetit që të kalojnë një kufi duke mos iu përmbajtur kërkesave për hyrje të ligjshme, për migrantët si në vijim:

(1) Në mes të datës 02 Tetor 2012 dhe 05 Tetor 2012, duke e ndihmuar A.C’n në kontrabandimin e N.S, qytetar Turk, nga Turqia përmes Kosovës në Mal të Zi dhe që andej për

---

<sup>1</sup> Që korrespondojnë me Nenet 33 dhe 170 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 i vitit 2012 (Kodi I Ri), dënimi të jetë në përputhje me Nenin 3 të saj

në një vend të Evropës, duke shërbyer si garantues në mënyrë që të ia mundësojë hyrjen e tij dhe kalimin përmes Kosovës, me datë 4-5 Tetor 2012;

(2) Në mes të datës 08 Nëntor 2012 dhe 30 Nëntor 2012, duke e ndihmuar A.C 'n në kontrabandimin e migrantit R.B, qytetar i Republikës së Turqisë, lindur me 01 Janar 1968, E.B, qytetar i Republikës së Turqisë, i lindur me 01 Janar 1966 dhe të tjerët, duke ndihmuar me sigurimin e një letër garancie nga T.Y për të mundësuar hyrjen e R.B në Kosovë me datë 11 Nëntor 2012 dhe kalimin përmes Kosovës me datë 11-13 Nëntor 2012, dhe të E.B në Kosovë me datë 19 Nëntor 2012 dhe kalimin përmes Kosovës me datë 19-22 Nëntor 2012, për në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) dhe që nga andej për ndonjë vend Evropian.

**PAS** mbajtjes së Seancës Fillestare me datë 29 Gusht 2014, në praninë e të pandehurit E.YI, avokatit të tij Rasim Hoti dhe në praninë e Prokurores së EULEX-it Salma Yousef,

**PAS** konsiderimit të Marrëveshjes mbi Fajësinë me datë 14 Maj 2014 dhe të parashtruar në Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës Themelore në Prizren me datë 14 Korrik 2014, Kryetari i trupit gjykues konstaton se i pandehuri i kupton natyrën dhe pasojat e marrëveshjes mbi fajësinë; pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me avokatin e tij; pranimi i fajësisë mbështetet nga faktet dhe provat materiale të çështjes që përmban aktakuza; se asnjë nga rrethanat nga neni 253, paragrafi 1 dhe 2 i këtij Kodi ekzistojnë dhe pas dëgjimit të paraqitjeve nga i pandehuri, avokati i tij dhe Prokurori,

**DUKE** pas pranuar Marrëveshjen me shkrim mbi Fajësinë PSRK Nr: 50/2011, me datë 14 Maj 2014, të parashtruar me Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës Themelore në Prizren me datë 14 Korrik 2014, në bazë të Nenit 233, paragrafi 21 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,

**SIPAS** Nenit 362 paragrafi 1, Neni 365 dhe Neni 366 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës me këtë datë të 29 Gushtit të vitit 2014, në një seancë të hapur për publik dhe në prani të të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës dhe Prokurores Speciale të EULEX-it, lëshon si në vijim:

## AKTGJYKIM

---

E.Y., me të dhëna personale si më lartë, me anë të kësaj shpallet

### FAJTOR

**SEPSE** E.Y e ka ndihmuar A.C 'n dhe të tjerët në kontrabandimin e migrantëve përtej kufijve në shtetet ku ata nuk kanë qenë shtetas apo banues të përhershëm duke mos iu përmbajtur kërkesave për hyrje të ligjshme. Posaçërisht,

**Mes datës 02 Tetor 2012 dhe 05 Tetor 2012, E.Y e ka ndihmuar A.C 'n në kontrabandimin e N.S, qytetar Turk, nga Turqia, përmes Kosovës për në Mal të Zi dhe pastaj në një vend Evropian, duke shërbyer si garantor në mënyrë që të ia mundësojë atij hyrjen në dhe kalimin përmes Kosovës me datë 04-05 Tetor 2012.**

Nga përgjimet e komunikimeve me email të A.C-s, është zbuluar se A.C ka organizuar një dokument të rrejshëm udhëtimi për N.S, lindur me 10 Janar 1971, qytetar i Republikës së Turqisë, pas marrjes së një kopjeje të dokumentit të tij Turk të identifikimit nga bashkëpunëtori i tij H.S me datë 02 Tetor 2012. Më tej, është zbuluar se A.C ka bërë rezervime hoteli për migrantin N.S tek NIRVANA ROOMS, Split, Kroaci, për datën 08 Tetor 2012. Sistemi i Monitorimit Kufitar të Policisë së Kosovës tregon se N.S ka hyrë në Kosovë duke fluturuar në aeroportin e Prishtinës me datë 04 Tetor 2012 në ora 19:56 para se të nisej nga Kosova për në Malin e Zi me makinë përmes vendkalimit kufitar Kulla e Pejës me datë 05 Tetor 2012 në ora 16:52.

E.Y ia ka dhënë një letër të rreme garancie migrantit për të ia mundësuar atij që të hyjë në Kosovë në transit, duke e ditur se migranti nuk e ka ndërmend që të mbetet në Kosovë, por se do të hyjë në mënyrë të paligjshme në vende të tjera me mbështetjen e A.C's. Ai gjithashtu e ka marrë migrantin nga aeroporti, së bashku me vozitësin S.S, duke ia dhënë perceptimin e rremë

autoriteteve se ai e njihte migrantin dhe ishte një garantues i ligjshëm për qëndrimin e tij në Kosovë.

Me datë 04 Tetor 2012 në ora 13:36:31 A.C e ka telefonuar E.Y dhe Y. e ka pyetur atë se ku ndodhej, në të cilën gjë A.C është përgjigjur se ai ishte në shtëpi dhe se së shpejti do dilte jashtë. E.Y e pyet A.C 'n nëse noteri tek Qafa ishte ende duke punuar. A.C e konfirmon që po ai ishte duke punuar dhe që të shkojnë atje për marrëveshjet. A.C paralajmëroi edhe për ndarjen e parave. E.Y theksoi se njëri nga ata qe i lindur më 1971. A.C shpjegoi se noteri do të merret me këtë dhe do të kërkojë për emrin dhe mbiemrin. Ai deklaroi se noteri do të kërkojë edhe arsyetimin e qëndrimit të personit dhe që nuk kishte nevojë për gjykatë. A.C shpjegoi se noteri do të marri paratë për punën e bërë dhe se detajet për noterin do të dërgohen me e-mail. A.C e ka udhëzuar E.Y që ta vizitojë noterin dhe që ti bëjë aranzhimet për udhëtarin i cili do nisej atë natë. Ai më tej ka theksuar se kur aranzhimet të jenë bërë, ato do i dërgohen udhëtarit i cili do të mund të rezervonte fluturimin për atë natë. E.Y pyeti nëse ai duhej që të shkonte tek noteri që ishte afër ndërtesës së Komunës por A.C e udhëzon atë që të shkojë tek noteri që ishte përballë dyqanit “ Sulltan” meqë noteri tjetër nuk bënte marrëveshje të tilla. E.Y në fakt, e kreu këtë ndihmesë, sipas udhëzimeve.

Me 04 Tetor 2012 në ora 19:56 min, N.S është marrë nga aeroporti i Prishtinës, nga vozitësi Sulejman Spahi, së bashku me E.Y në cilësinë e garantuesit të tij që ta sigurojë hyrjen e tij në Kosovë. Kjo qe konfirmuar nga E.Y në dëshminë e tij të procedurës paraprake dhënë në Polici me datë 06 Shkurt 2013.

**Më tej, në mes të datës 08 Nëntor 2012 dhe 30 Nëntor 2012, E.Y e ka ndihmuar A.C 'n në kontrabandimin e migrantit R.B, qytetar i Republikës së Turqisë, i lindur me 01 Janar 1968, E.B, qytetar i Republikës së Turqisë i lindur me, 01 Janar 1966 dhe të tjerët, duke ndihmuar me sigurimin e një letër garancie nga T.Y që ta mundësojë hyrjen e R.B në Kosovë me datë 11 Nëntor 2012 dhe kalimin nëpër Kosovë me 11-13 Nëntor 2012, dhe të E.B në Kosovë me datë**

**19 Nëntor 2012 dhe kalimin përmes Kosovës me 19-22 Nëntor 2012, për në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) dhe në vazhdim në një vend Evropian.**

A.C organizoi një dokument të falsifikuar të udhëtimit për R.BN'n pas marrjes së një kopje të pasaportës së tij Turke nga bashkëpunëtorja e tij Belirsiz Efsane me datë 27 Tetor 2012. Sistemi i Monitorimit Kufitar i Policisë së Kosovës ka zbuluar se R.B ka hyrë në Kosovë duke fluturuar në aeroportin e Prishtinës me datë 11 Nëntor 2012 në ora 11:44 dhe pastaj e ka lëshuar Kosovën me autobus përmes kalimit kufitar në Han të Elezit duke kaluar në IRJ të Maqedonisë me datë 13 Nëntor 2012 në ora 16:43:00.

A.C organizoi një dokument të falsifikuar të udhëtimit për E.B. Sistemi i Monitorimit Kufitar i Policisë së Kosovës ka zbuluar se E.B ka hyrë në Kosovë duke fluturuar në aeroportin e Prishtinës me datë 19 Nëntor 2012 në 4:43:21 dhe pastaj e ka lëshuar Kosovën me autobus përmes kalimit kufitar në Han të Elezit duke kaluar në IRJ të Maqedonisë me datë 22 Nëntor 2012 në ora 16:43:21.

Letra e Garancionit dhe transporti nga aeroporti i Prishtinës për këta migrantë është siguruar nga T.Y, sipas udhëzimeve të A.C's. E.Y e ka ndihmuar T.Y në këtë detyrë, po ashtu me udhëzime nga A.C. Me datë 08 Nëntor 2012 në ora 16:06:43 A.C i ka telefonuar T.Y. Me datë 08 Nëntor 2012 në ora 16:09:42 A.C telefonon E.Y. A.C i thotë E.Y se T. do ta vizitonte atë. E.Y përgjigjet se ai ndodhej afër kafenesë së katit të 2-të. A.C thotë që T. do të vinte aty. T. i kishte vetëm 10 euro për noterin. A.C e pyet E.Y nëse ai mund të i ipte atij ca para. Me datë 12 Nëntor 2012 në ora 17:54:36, A.C është telefonuar nga E.Y në lidhje me çështjen.

**NË KËTË MËNYRË** i pandehuri e ka kryer veprën penale të **DHËNIA E NDIHMËS NJË EPRSONI TJETËR NË KONTRABANDIMIN E MIGRANTËVE**, në kundërshtim me Nenin 25 paragrafi 1 dhe Neni 138 paragrafi 6 i Kodit Penal të Kosovës, Ligji Nr.03/L-002 i datës 6 Nëntor 2008.

**DUKE** qenë i shpallur fajtor për veprën penal të Dhënies së ndihmës një personi tjetër në Kontrabandimin me Migrantë, sipas Nenit 25, paragrafi 1 dhe Neni 138, paragrafi 6 i Kodit Penal të Kosovës, **NË BAZË TË** Neneve 41, paragrafi 1, nën-paragrafët 1, 42, 43, 44, 45, 46 dhe 48 të Kodit Penal të Kosovës, kjo Gjykatë shqipton si në vijim

## **DËNIM ME KUSHT**

Duke ia caktuar një afat burgimi prej 2(dy) vite, ekzekutimi i të cilit dënim nuk do bëhet nëse personi nuk e kryen një vepër tjetër penale brenda periudhës kohore prej 2 (dy) vitesh.

**NË BAZË TË** Neneve 450, 451 dhe 453 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i Akuzuari do bëj reimbursimin e shpenzimeve të procedurës penale, të vlerësuar në shumë prej 100 ( një qind) Eurosh.

Çdo kërkesë pasurore juridike mund të ndiqet përmes gjykatave civile.

Palët u tërhoqën nga e drejta për të apeluar aktgjykimin në fjalë.

## **Arsyetimi**

### **A. HYRJE**

#### **I. Sfondi Procedural**

Me datë 11 Dhjetor 2012, prokurori ka parashtruar një Aktvendim kundër O.A dhe B.F. Me datë 13 Shkurt 2012, prokurori parashtrroi Aktakuzën e ndryshuar për të përfshirë një të pandehur shtesë, F.A, në po të njëjtën procedurë.

Gjykimi i O.A, B.F dhe F.AT ka përfunduar, duke përfunduar në shkallën e parë me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit të datës 6 Shtator 2013.

Ndaras, me datë 16 Prill 2013 Prokurori ka parashtruar një aktakuzë kundër A.BT. Gjykimi i A.BT ka përfundua, duke përfunduar në shkallën e parë me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit shqiptuar më 29 Tetor 2013 me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Me 11 Dhjetor 2013, Prokurori ka parashtruar një aktakuzë kundër A.C, M.B, A.M, I.P, A.B, M.A, T.Y, S.S dhe A.G.

Aktakuza e PSRK-së PPS Nr: 50/2011 kundër E.Y është ngritur në kontekstin e njëjtë hetimit penal.

Ky rast është hetuar nga një grupi i përbashkët hetimor i përbërë nga hetuesit nga të dyja njësitë, Njësia e Hetimit të Krimin të Organizuar e Policisë së EULEX-it (NJHKO) dhe Departamenti i Policisë së Kosovës për Hetimin e Krimin të Organizuar (DKO).

Me 10 Maj 2011, PSRK-ja ka marrë një kërkesë për ndihmë juridike ndërkombëtare (NJN) Kërkesa nga Prokurori Publik i Qarkut në Lubjanë, Republika e Sllovenisë me referencë TPP-S-1 27/2010 – DŠ e datës 21 Prill 2011, në lidhje me një të dyshuar për tu identifikuar si O.A.

Me 11 Korrik 2011, Prokurori ka lëshuar një Aktvendim për Fillimin e Hetimeve kundër O.A. Me 11 Janar 2012 dhe 11 Korrik 2012, Gjyqtari I procedurës paraprake e ka aprovuar vazhdimin e hetimeve edhe për gjashtë muaj shtesë. Hetimet kundër tij është dashur që të përfundojnë me datë 11 Janar 2013.

Me datë 14 dhjetor 2011, Prokurori ka lëshuar një Aktvendim mbi Zgjerimin e Hetimeve për B.FN. Me 15 Qershor 2012, Gjyqtari I procedurës paraprake e ka aprovuar vazhdimin e hetimeve edhe për gjashtë muaj shtesë. Hetimet kundër tij kanë përfunduar me datë 14 Dhjetor 2012.

Me 20 Janar 2012, Prokurori ka lëshuar aktvendimin e tretë për Zgjerimin e Hetimeve për F.A. Pas një hetimi, Hetimet kundër tij do të skadonin me datë 20 Janar 2013.

Me 20 Janar 2012, Prokurori ka lëshuar një Aktvendim mbi Zgjerimin e Hetimeve kundër A. M I cili më vonë qe identifikuar si A.B.

Me 21 Mars 2012, Prokurori ka lëshuar një Aktvendim mbi Zgjerimin e Hetimeve për A.BN. Me 20 shtator 2012, gjyqtari i procedurës paraprake e ka aprovuar zgjatjen e hetimeve edhe për gjashtë muaj shtesë. Hetimet kundër tij qe caktuar më parë që të skadojnë me datë 21 Mars 2013 por në bazë të Nenit 159 (1)të KPPK-së, Ligji 04/L-123 I vitit 2012, do skadonin me datë 21 Mars 2014.

Me 17 Gusht 2012, Prokurori ka lëshuar një Aktvendim mbi Zgjerimin e Hetimeve për A.C 'n.

Me 05 shtator 2012, Prokurori ka lëshuar një Aktvendim mbi Zgjerimin e Hetimeve për N. A. Me 02 Nëntor 2012, Prokurori ka lëshuar aktvendimin e ndryshuar mbi Zgjerimin e hetimeve ndaj N. N., duke vijuar me re-identifikimin e këtij të pandehuri.

Me 03 Dhjetor 2012, Prokurori ka lëshuar një Aktvendim mbi Zgjerimin e Hetimeve për M.BN.

Me 05 dhjetor 2012, Prokurori ka lëshuar një Aktvendim mbi Zgjerimin e Hetimeve për M.A, A.M, A.G, I.P, T.Y, S.S, B.B, M.B dhe E.Y.



Me 14 Dhjetor 2012, Prokurori ka lëshuar një Aktvendim mbi Zgjerimin e Hetimeve për A.B.

Të dyshuarit e tjerë ishin pjesë e rastit të njëjtë dhe hetimet ndaj tyre janë në vazhdim e sipër.

Aktakuza e PSRK-së PPS Nr: 50/2013, e datës 07 Korrik 2014 e Prokurorit të EULEX-it që parashtruar me Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës Themelore në Prizren me datë 11 Korrik 2014.

## **II. Juridiksioni**

Neni 11 I Ligjit mbi Gjykatat<sup>2</sup> parashikon se Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë në të gjitha rastet, përveç kur me ligj parashihet ndryshe.

Neni 15 I Ligjit në fjalë parashikon që Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore ka juridiksion për të gjykuar në shkallë të parë në rastet e veprave penale të Kontrabandimit të Migrantëve.

I pandehuri është akuzuar për veprën penale të ofrimit të Ndhmës një personi tjetër në Kontrabandimin e Migrantëve sipas Nenit 25 paragrafi 1 dhe Neni 138 paragrafët 1, 2 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës.

Gjyqtari i poshtë nënshkruar është kompetent për të gjykuar këtë rast sipas Neneve 20, 21, 22, 25, 26 dhe 29 të KPP-së dhe Ligjit mbi Gjykatat, Ligji nr.03/L-199.

KPK që ka hyrë në fuqi me datë 01 Janar 2013 I ka ri-klasifikuar Gjykatat e Qarkut si Gjykata Themelore.

Gjykata Themelore në Prizren ka juridiksion territorial mbi rastin sipas Nenit 29 të KPP-së.

---

<sup>2</sup> Ligji Nr. 03/L-199

## **B.LIGJI**

### **I. Ligji penal në fuqi**

Duke qenë I dënuar për veprën penale të dhënies së Ndhmës një personi tjetër në Kontrabandimin me Migrantë, sipas Nenit 25 paragrafi 1 dhe Neni 138 paragrafi 6 i KPP-së, Gjykata konstaton se Neni 138 paragrafi 6 i KPP-së i “Kodit të vjetër” shkon më shumë në favor të të pandehurit.

#### **i. Kodi I Procedurës**

Aktakuza ishte ngritur pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale. Nuk ka diskutim se Kodi i ri i procedurës penale është i zbatueshëm në këtë rast.

## **C. KONSIDERATAT NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E PROVAVE**

### **I. Barra dhe standardi i provës**

Sipas Nenit 6 (2) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm “KEDNJ”), Kushtetutës së Kosovës dhe Nenit 3 (1) të KPP-së, parashikojnë prezumimin e pafajësisë për të cilën i Akuzuari ka të drejtë. Ky prezumim ia vë në barrë Prokurorisë që të përcaktojë fajësinë e të Akuzuarit, një barrë e cila mbetet mbi Prokurorinë përgjatë tërë gjykimit.

Neni 370 (7) i KPP-së përcakton se *‘gjykata duhet të theksojë në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte ajo i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për këtë’*. Prandaj, Trupi Gjykses duhet të vendosë nëse ai është i kënaqur në bazë të të gjithë provave në mënyrë

që të jetë i sigurtë se çdo element i këtij krimi është përcaktuar. Çdo dyshim duhet të zgjidhet në favor të të akuzuarit.

Trupi gjykues në bazë të Nenit7 (1), (2) të KPP-së '*...që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm dhe '...detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato... në favor të tij ...'*.

#### **D. VLERËSIMI I PROVAVE**

I pandehuri që akuzuar në Aktakuzë me dhënien e Ndhmës një personi tjetër në Kontrabandimin me migrantë sipas Nenit 25 paragrafi 1 dhe 138 paragrafët 1, 2 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës.

I Pandehuri ka hyrë në një Marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë me Prokurorin me datë 14 Maj 2014. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë u pranua nga Gjykata gjatë seancës fillestare të mbajtur më 29 Gusht 2014. Gjetjet faktike për të cilën është bërë referencë në këtë dokument ishin bazë me shkrim të Marrëveshjes mbi fajësinë. Duke shqyrtuar provat mbi të cilat Prokuroria mbështetet, Kryetari i trupit gjykues konstatoi se i pandehuri e ka ndihmuar A.C 'n dhe të tjerët në kontrabandimin e migrantëve me origjinë Turke. Në mënyrë të veçantë, kryetari i trupit gjykues konstaton se

**(1) Mes datës 02 Tetor 2012 dhe 05 Tetor 2012, E.Y e ka ndihmuar A.C 'n në kontrabandimin e N.S, qytetar Turk, nga Turqia, përmes Kosovës për në Mal të Zi dhe pastaj në një vend Evropian, duke shërbyer si garantor në mënyrë që të ia mundësojë atij hyrjen në dhe kalimin përmes Kosovës me datë 04-05 Tetor 2012.**

Nga përgjimet e komunikimeve me e-mail të A.C's, është zbuluar se A.C ka organizuar një dokument të rrejshëm të udhëtimit për N.S, i lindur me 10.01.1971, qytetar i Republikës së

Turqisë, pas marrjes së një kopjeje të dokumentit të identitetit të tij Turk nga bashkëpunëtori i tij H.S me datë 2 Tetor 2012.<sup>3</sup> Më tej, është zbuluar se A.C ka bërë rezervime hoteli për migrantin N.S tek NIRVANA ROOMS, Split, Kroaci për datën 08 Tetor 2012 (emali i dërguar është i datës 6.10.2012).<sup>4</sup> Sistemi i Monitorimit Kufitar i Policisë së Kosovës zbulon se N.S ka hyrë në Kosovë duke fluturuar në aeroportin e Prishtinës me datë 04 Tetor 2012 në ora 19:56 para se të nisej nga Kosova për në Malin e Zi me makinë përmes vendkalimit kufitar Kulla Pejës më me datë 05 Tetor 2012 në ora 16:52.<sup>5</sup>

E.Y ia ka dhënë një letër të rreme garancie migrantit për të ia mundësuar atij që të hyjë në Kosovë në transit, duke e ditur se migranti nuk e ka ndërmend që të mbetet në Kosovë, por se do të hyjë në mënyrë të paligjshme në vende të tjera me mbështetjen e A.C's. Ai gjithashtu e ka marrë migrantin nga aeroporti, së bashku me vozitësin S.S, duke ia dhënë perceptimin e rremë autoriteteve se ai e njihte migrantin dhe ishte një garantues i ligjshëm për qëndrimin e tij në Kosovë.

Provat kundër Y. ndodhen në përgjimin e ligjshëm të A.C's, regjistrimet telefonike dhe ekzaminimet forenzike të IT-së të telefonave të E.Y dhe A.C si dhe vetë letra e garancisë.

---

<sup>3</sup> Policia e EULEX-it , NJHKO 4855, Raporti Policor 15 ditor mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik (A.C) që mbulon periudhën prej 21/06/2012 – 11/10/2012, me datë 17/10/2012, (PSRK/në/1212/OC e datës 19/10/2012), Dosja policore ngjyrë rozë PINK 2, vol. 3, Pika 1, fq. 1-17

<sup>4</sup> Policia e EULEX-it , NJHKO 4855, raporti Policor 15 ditor mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik (A.C) që mbulon periudhën prej 21/06/2012 – 11/10/2012, me datë 17/10/2012, (PSRK/në/1212/OC e datës 19/10/2012), Dosja policore ngjyrë rozë PINK 2, vol. 3, Pika 1, fq. 1-17.

<sup>5</sup> Policia e Eulex-it, Raporti I NJHKO-së 5246 në lidhje me kalimin kufitar të migrantëve, I datës 15/01/2013 (PSRK/in/52/OC me datë 17/01/2013), Dosja policore ngjyrë rozë PINK 2, vol. 6, Pika 5, fq. 135-143

Me datë 04 Tetor 2012 në ora 13:36:31 A.C e ka telefonuar E.Y dhe Y. e ka pyetur atë se ku ndodhej, në të cilën gjë A.C është përgjigjur se ai ishte në shtëpi dhe se së shpejti do dilte jashtë. E.Y e pyet A.C 'n nëse noteri tek Qafa ishte ende duke punuar. A.C e konfirmon që po ai ishte duke punuar dhe që të shkojnë atje për marrëveshjet. A.C paralajmëroi edhe për ndarjen e parave. E.Y theksoi se njëri nga ata që i lindur më 1971. A.C shpjegoi se noteri do të merret me këtë dhe do të kërkojë për emrin dhe mbiemrin. Ai deklaroi se noteri do të kërkojë edhe arsyetimin e qëndrimit të personit dhe që nuk kishte nevojë për gjykatë. A.C shpjegoi se noteri do të marri paratë për punën e bërë dhe se detajet për noterin do të dërgohen me e-mail. A.C e ka udhëzuar E.Y që ta vizitojë noterin dhe që ti bëjë aranzhimet për udhëtarin i cili do nisej atë natë. Ai më tej ka theksuar se kur aranzhimet të jenë bërë, ato do i dërgohen udhëtarit i cili do të mund të rezervonte fluturimin për atë natë. E.Y pyeti nëse ai duhej që të shkonte tek noteri që ishte afër ndërtesës së Komunës por A.C e udhëzon atë që të shkojë tek noteri që ishte përballë dyqanit " Sulltan" meqë noteri tjetër nuk bënte marrëveshje të tilla. E.Y në fakt, e kreu këtë ndihmesë, sipas udhëzimeve.

Me 04 Tetor 2012 në ora 19:56 min, N.S është marrë nga aeroporti i Prishtinës, nga vozitësi Sulejman Spahi, së bashku me E.Y në cilësinë e garantuesit të tij që ta sigurojë hyrjen e tij në Kosovë. Kjo që konfirmuar nga E.Y në dëshminë e tij të procedurës paraprake dhënë në Polici me datë 06 Shkurt 2013.

**(2) Mes datave 08 Nëntor 2012 dhe 30 Nëntor 2012, E.Y e ka ndihmuar A.C 'n në kontrabandimin e migrantit R.B, qytetar i Republikës së Turqisë, i lindur me 01 Janar 1968, E.B, qytetar i Republikës së Turqisë i lindur me, 01 Janar 1966 dhe të tjerët, duke ndihmuar me sigurimin e një letër garancie nga T.Y që ta mundësojë hyrjen e R.B në Kosovë me datë 11 Nëntor 2012 dhe kalimin nëpër Kosovë me 11-13 Nëntor 2012, dhe të E.B në Kosovë me datë 19 Nëntor 2012 dhe kalimin përmes Kosovës me 19-22 Nëntor 2012, për në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) dhe në vazhdim në një vend Evropian.**

Nga përgjimet e komunikimeve me e-mail të A.C's, është zbuluar se A.C organizoi një dokument të falsifikuar të udhëtimit për R.BN'n, pas pranimit të një kopjeje të pasaportës së tij Turke nga bashkëpunëtori i tij B.E lindur me 27 Tetor 2012.<sup>6</sup> Sistemi i Monitorimit Kufitar i Policisë së Kosovës ka zbuluar R.B ka hyrë në Kosovë duke fluturuar në aeroportin e Prishtinës me datë 11 Nëntor 2012 në ora 11:44 dhe pastaj e ka lëshuar Kosovën me autobus përmes kalimit kufitar në Han të Elezit duke kaluar në IRJ të Maqedonisë me datë 13 Nëntor 2012 në ora 16:43:00.<sup>7</sup>

Nga përgjimet e komunikimeve me e-mail të A.C's, është zbuluar se A.C organizoi një dokument të falsifikuar të udhëtimit për E.B. Sistemi i Monitorimit Kufitar i Policisë së Kosovës ka zbuluar se E.B ka hyrë në Kosovë duke fluturuar në aeroportin e Prishtinës me datë 19 Nëntor 2012 në ora 16:43:21 dhe pastaj e ka lëshuar Kosovën me autobus përmes kalimit kufitar në Han të Elezit duke kaluar në IRJ të Maqedonisë me datë 22 Nëntor 2012 në ora 16:43:21.<sup>8</sup>

I pandehuri nuk është i dyshuar se ka qenë një anëtar i grupit të organizuar kriminal. I pandehuri gjithashtu nuk është i akuzuar se ka ndihmuar A.C 'n apo të tjerët në kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar.

Roli i E.Y kufizohet në dhënien e Ndhmës në kryerjen e veprës penale të Kontrabandimit me Migrantë me veprimet e vogla të sipërpërmendura.

## A. DËNIMI

---

<sup>6</sup> Raporti I Policisë së EULEX-it 4928, një raport 15 ditor mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik (A.C), që mbulon periudhën prej 12/10/2012-28/10/2012, me datë 30/10/2012(PSRK/in/1251/OC e datës 01/11/2012) dosja e policisë ngjyre rozë PINK 2, vol 1, pika 18, fq 234-237.

<sup>7</sup> Raporti I policisë së EULEX-it NJHKO 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve, data15/01/2013 (PSRK/in/52/OC e datës 17/01/2013), Dosja policore me ngjyrë rozë PINK 2, vol. 6, Pika 5, fq. 135-143

<sup>8</sup> Raporti I policisë së EULEX-it NJHKO 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve, data 15/01/2013 (PPRK/in/52/OC e datës 17/01/2013), Dosja policore me ngjyrë rozë 2, vol. 6, Pika 5, fq. 135-143

I pandehuri është 52 vjeçar. Ai është i martuar dhe ka dy fëmijë.

Gjykata konsideroi se dënimi me kusht prej 2 (dy) vjet me kohën e verifikimit prej 2 (dy) vjet të jetë i arsyeshëm dhe proporcional.

Gjykata konstatoi se dispozitat e Nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale janë përmbushur dhe se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është lidhur vullnetarisht nga ana e të akuzuarit dhe se ai e kuptoi rëndësinë e saj dhe pasojat në lidhje me sjelljen e tij të ardhshme në kohën që ai e ka nënshkruar. Gjykata konstaton se kopjet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë janë mbajtur nga palët dhe një kopje është ruajtur në dosjen e Gjykatës.

Palët janë tërhequr nga e drejta e tyre për të apeluar aktgjykimin në fjalë

Për arsyet e cekura këtu, Kryetari i trupit gjykues konstaton sikurse në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

---

**Gjyqtari Malcolm Simmons**  
**Kryetar i trupit gjykues**

---

**Valentina Gashi**  
**Procesmbajtëse**